

VENDIM
Nr. 632, datë 28.9.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT (ASISTENCA TEKNIKE)
PËR KONEKTIVITETIN E RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE PËR
SHQIPËRINË – MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË (MARRËSI), FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT (ENTI I PROJEKTIT) DHE BANKËS EVROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, MBËSHTETUR NGA FONDI I POSAÇËM I
AKSIONARËVE TË BERZH-it**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit (asistenca teknike) për konektivitetin e rrugëve rajonale dhe lokale për Shqipërinë – mbështetje për zbatimin e projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (enti i projektit) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, mbështetur nga fondi i posaçëm i aksionarëve të BERZH-it, në shumën 1 200 000 USD (një milion e dyqind mijë dollarë), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Marrëveshje Granti nr. 2021.004131
sipas **DTM-së nr. 50123/ TCRS nr. 9900/59901**

MARRËVESHJE GRANTI (ASISTENCA TEKNIKE)
**PËR SHQIPËRINË: PROJEKTI I KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE
DHE LOKALE – MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË (“MARRËSI”), DHE FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT (“ENTI I PROJEKTIT”), DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, MBËSHTETUR NGA FONDI I POSAÇËM I AKSIONARËVE TË
BERZH-it**

DATË 17 QERSHOR 2022

TABELA E LËNDËS

NENI I – PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMI

Pika 1.01 Përkufizime

Pika 1.02 Interpretimi

NENI II – FINANCIMI I GRANTIT

Pika 2.01 Shuma dhe qëllimi

Pika 2.02 Disbursimi i Grantit

Pika 2.03 Pagesat

Pika 2.04 Taksat dhe tatimet

NENI III – KUSHTET PARAPRAKE

Pika 3.01 Pagesa e parë e Grantit

Pika 3.02 Të gjitha pagesat e Grantit	
NENI IV - DETYRIMET E PALËVE	
Pika 4.01 Kryerja e biznesit dhe veprimeve	
Pika 4.02 Përdorimi i Grantit	
Pika 4.03 Marrëveshja e Huas	
Pika 4.04 Prokurimi	
Pika 4.05 Kontratat	
Pika 4.06 Siguracioni	
Pika 4.07 Evidencat dhe raportet financiare	
Pika 4.08 Dhënia e informacionit	
Pika 4.09 Mashtrimi dhe korrupsioni	
Pika 4.10 Vizibiliteti	
Pika 4.11 Inspektimi dhe auditimi	
NENI V – PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË	
Pika 5.01 Përfaqësimet	
Pika 5.02 Pranimi dhe përsëritja	
NENI VI – PEZULLIMI DHE ANULIMI	
Pika 6.01 Anulimi nga Marrësi	
Pika 6.02 Pezullimi ose anulimi i pagesave	
Pika 6.03 Rastet e rimbursimit	
NENI VII – TË NDRYSHME	
Pika 7.01 Zbatueshmëria; Afati dhe zgjidhja	
Pika 7.02 Mbetja në fuqi pas marrëveshjes	
Pika 7.03 Marrëveshja e plotë; ndryshimi dhe heqja dorë	
Pika 7.04 Njoftimet	
Pika 7.05 Gjuha angleze	
Pika 7.06 Të drejtat, mjetet juridike dhe heqja dorë	
Pika 7.07 Përgjegjësia dhe dëmshpërblimi	
Pika 7.08 Legjislacioni rregullues	
Pika 7.09 Arbitrazhi dhe juridiksioni	
Pika 7.10 Pasuesit dhe drejtëmarrësit; Të drejtat e palëve të treta	
Pika 7.11 Nxjerrja e të dhënave	
Pika 7.12 Kopjet	
PASQYRA A: FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË	
PASQYRA B: FORMULARI I SHKRESËS QË ÇAKTON NËNSHKRUESIT E	
AUTORIZUAR	
SKEDULI 1: ZËRAT E FINANCUAR NGA GRANTI	

MARRËVESHJA E GRANTIT NR. 2021.004131

Kjo Marrëveshje Granti (“Marrëveshja”), datë 17 maj 2022, lidhet ndërmjet:

1. Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një institucion financiar ndërkombëtar i krijuar në bazë të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një traktat shumëpalësh, i nënshkruar në Paris, më 29 maj 1990, me seli në adresën: “One Exchange Square”, London EC2A 2JN, United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar) (“BERZH”); dhe

2. Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë, Shqipëri (Marrësi).

3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, një shoqëri e organizuar dhe që ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit shqiptar, me adresë: Rruga “Sami Frashëri” 10, Tiranë 1001, Shqipëri (“Enti i Projektit” dhe së bashku me BERZH-in dhe Marrësin, “Palët”).

Duke pasur parasysh, se:

A. Më 10 shkurt 2020, BERZH (në cilësinë e huadhënësit) lidhi një marrëveshje huaje

(“Marrëveshja e Huas”) me Marrësin (në cilësinë e huamarrësit) në zbatim të së cilës BERZH-i ra dakord që të japë hua deri në 50,000,000.00 dollarë amerikanë për financimin e një programi të përgjithshëm investimi, me qëllim rehabilitimin e seksioneve kyçe të rrjetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri (“Projekti”). Marrësi i ka kërkuar BERZH-it, që të financojë disa veprimtari të asistencës teknike në mbështetje të Projektit.

B. Në zbatim të nenit 18 të Marrëveshjes së Themelimit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, BERZH-i ka ngritur Fondin e Posaçëm të Aksionarëve të BERZH-it (“Fondi” ose “Donatori”), të cilin e menaxhon dhe administron.

C. BERZH-i ka rënë dakord që të ofrojë një grant në shumën 1,200,000.00 dollarë amerikanë nga Fondi, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, për prokurimin e disa Shërbimeve Konsulente të përshkruara në skedulin 1 (*Zërat e Financuar nga Granti*) të kësaj Marrëveshjeje.

D. Marrësi ka rënë dakord që Enti i Projektit do të zgjedhë dhe angazhojë çdo konsulent, duke lidhur kontrata në bazë të të cilave secili konsulent do t’i ofrojë Shërbimet e Konsulencës Marrësit/Entit të Projektit.

Me anë të kësaj palët bien dakord, si më poshtë:

Neni I

Përkufizime dhe Interpretimi

Pika 1.01 Përkufizime

a) Me përjashtim kur përkufizohen në paragrafin “b” më poshtë, përveç nëse konteksti e përcakton ndryshe, termat me shkronja të mëdha që përkufizohen në Marrëveshjen e Huas kanë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.

b) Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë klauzolat, pasqyrat dhe skedulet), përveç nëse konteksti përcakton ndryshe, termat me shkronja të mëdha kanë kuptimet e mëposhtme:

“Ditë Pune” është një ditë (përveç të shtunës ose të dielës), kur bankat tregtare janë të hapura për biznes të përgjithshëm në Londër, Angli.

“Konsulentë” është çdo konsulent me imazh dhe reputacion të mirë, i angazhuar nga Enti i Projektit që do të kryejë Shërbimet e Konsulencës.

“Kontratë Konsulente” është çdo kontratë e lidhur ndërmjet Entit të Projektit dhe Konsulentit përkatës, për kryerjen e Shërbimeve të Konsulencës.

“Shërbimet e Konsulencës” janë shërbimet që do të ofrohen nga çdo Konsulent, në lidhje me Projektin, siç përshkruhen më tej në skedulin 1 (*Zërat e Financuar nga Granti*).

“Donator/ët” ka kuptimin që i është dhënë në klauzolën B.

“Politikat dhe Procedurat e Zbatimit” janë Politikat dhe Procedurat e Zbatimit të BERZH-it, datë 4 tetor 2017, të cilat mund të gjenden në: <http://www.ebrd.com/news/publications/policies/enforcement-policy-and-procedures.html>, të ndryshuara herë pas here, si dhe çdo politikë apo procedurë të miratuar nga BERZH-i si pasuese ose zëvendësuese të këtyre politikave dhe procedurave.

“Fond” ka kuptimin që i është dhënë në klauzolën B.

“Zërat e Financuar nga Granti” janë Shërbimet e Konsulencës të nevojshme për Projektin dhe për t’u financuar tërësisht nga Granti, siç përshkruhen më tej në skedulin 1 (*Zërat e Financuar nga Granti*).

“Grant” ka kuptimin që i është dhënë në pikën 2.01(a) (*Shuma dhe Qëllimi*).

“Marrëveshje Huaje” ka kuptimin që i është dhënë në klauzolën A.

“Hua” është financimi i bërë ose për t’u vënë në dispozicion nga BERZH-i për Marrësin në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas.

“Pagesë (Disbursim)” është disbursimi, herë pas here, i ndonjë pjese të Grantit sipas pikës 3.02 (*Pagesat*).

“Kërkesë për Pagesë” është një kërkesë për Pagesë, në formularin e Pasqyrës A (*Formulari i Kërkesës për Pagesë*) dhe në përmbajtje të pranueshme për BERZH-in, e cila i dorëzohet BERZH-it në përputhje me pikën 2.02 (a) (*Pagesat e Grantit*).

“Politikat dhe Rregullat e Prokurimit” janë rregullat e prokurimit të BERZH-it për veprimet e sektorit publik, të ndryshuara herë pas here.

“Praktikë e Ndaluar” është një praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese, shpërdorim i burimeve të bankës ose aktivëve bankarë, praktikë penguese ose vjedhje, sipas përkufizimeve të secilit prej këtyre termave në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

“Projekt” ka kuptimin që i është dhënë në klauzolën A.

“Rast Rimbursimi” është cilado ngjarje apo rast i përcaktuar në Pikën 6.03 (*Rastet e Rimbursimit*).

“Shpagim” është çdo veprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i dëmshëm, i rekomanduar, i paralajmëruar ose i ndërmarrë.

“Taksë” janë të gjitha taksat, rentat, pullat apo tatimet, vlerësimi, shuma e taksës, pagesa, tatimi mbi vlerën e shtuar ose tatimi i çfarëdolloj natyre (përfshirë të gjitha penalitetet apo interesat përkatëse) të vendosura sipas ndonjë ligji.

Pika 1.02 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

- a) nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjellat;
- b) titujt dhe “Tabela e lëndës” janë vendosur vetëm për lehtësi reference dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;
- c) fjalët që tregojnë persona përfshijnë korporata, partneritete dhe persona të tjerë juridikë, dhe referencat për një person përfshijnë pasuesit e tij dhe të caktuarit e lejuar;
- d) një referencë për një nen, pikë, skedul ose pasqyrë të specifikuar interpretohet si referencë për atë nen ose pikë, ose skedul apo pasqyrë të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje;
- e) çdo referencë për “legjislacionin” nënkupton çdo ligj (përfshirë të drejtën zakonore) dhe çdo traktat, kushtetutë, statut, legjislacion, dekret, akt normativ, rregull, rregullore, gjykim, urdhër, urdhër gjykate, vendim gjykate, përcaktim, lidhje marrëveshjeje apo çdo masë tjetër legjislative, administrative apo gjyqësore ose vendim arbitrazhi në çdo juridiksion që ka fuqinë e ligjit ose përputhshmëria e me të cilin është në pajtim me praktikën e përgjithshme në këtë juridiksion;
- f) çdo referencë të një dispozitë ligji është referencë tek ajo dispozitë sipas ndryshimeve apo rihyrjes në fuqi herë pas here; dhe
- g) “kontroll” (duke përfshirë me termat e lidhur me të “kontrolluar nga” dhe “nën kontroll të përbashkët me”), kur përdoren lidhur me ndonjë person, kanë kuptimin e zotërimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të autoritetit për të drejtuar ose marrë masa për drejtimin e menaxhimit dhe politikave të këtij personi, qoftë përmes pronësisë së aksioneve me të drejtë vote, kontratës apo ndryshe.

Neni II

Financimi i Grantit

Pika 2.01 Shuma dhe qëllimi

a) Në zbatim dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, BERZH-i bie dakord që t'i japë Marrësit, nga burimet e Fondit, një grant në shumën totale prej **1,200,000.00 dollarësh amerikanë** (“**Granti**”);

b) Granti do të përdoret vetëm për qëllime të financimit të Zërave të Financuar nga Granti;

c) Sipas pikës 6.03 (b) (*Rastet e Rimbursimit*), Granti nuk është i rimbursueshëm;

d) Marrësi dhe Enti i Projektit pranojnë dhe bie dakord shprehimisht se BERZH-i nuk do të jetë i detyruar që të kryejë ndonjë Disbursim ose pagesë tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç në masën që fondet e mjaftueshme janë vënë në dispozicion nga Fondi/Evropa Qendrore për këtë qëllim.

Pika 2.02 Disbursimi i Grantit

a) Sipas Pikës 6.02 (*Peçullimi ose Anulimi i Pagesave*) dhe nenit III (*Kushtet Paraprake*), BERZH-i disburson Grantin herë pas here në një Ditë Pune, në një ose më shumë Pagesa (Disbursime), me kërkesë të Entit të Projektit. Çdo Kërkesë për Pagesë, e shoqëruar me dokumentacionin mbështetës përkatës, dorëzohet në mënyrë elektronike në format PDF-je në adresën e postës elektronike të Departamentit të Bankës për Veprimet e Financuara nga Donatori, si më poshtë: APIInvoices@ebrd.com (përveç kur Entit të Projektit i është dhënë shprehimisht një adresë tjetër e postës elektronike, sjellë në vëmendjen e Marrësit nga Banka). Çdo dokumentacion mbështetës, në një gjuhë të ndryshme nga gjuha angleze, shoqërohet me përkthimin në gjuhën angleze, në përputhje me pikën 7.05 (*Gjuha angleze*) të kësaj Marrëveshjeje. Enti i Projektit garanton që çdo Kërkesë për Pagesë të merret nga Banka në adresën e mësipërme të postës elektronike të paktën 10 Ditë Pune para datës së propozuar të kësaj Pagese. Përveç kur BERZH-i bie dakord ndryshe, Kërkesa për Pagesë është e pakthyeshme dhe detyruese për Entin e Projektit.

b) Përveç kur është rënë dakord ndryshe nga BERZH-i, Enti i Projektit nuk kërkon Pagesë pas 3 viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pjesë e padisbursuar e Grantit anulohet automatikisht në ditën pasuese.

c) Përveç kur Palët bien dakord ndryshe me shkrim, Pagesat bëhen vetëm për të financuar shpenzimet e kryera (ose, nëse Palët bien dakord, shpenzimet që do të kryhen), në lidhje me kostot e arsyeshme të Zërave të Financuar nga Granti.

d) Pagesat bëhen në **dollarë amerikanë**.

e) Pagesat (përveç një Pagese të të gjithë shumës së padisbursuar të Grantit) bëhen në shuma jo më të ulëta se **50,000.00 dollarë amerikanë** dhe jo më shumë se një herë në muaj.

Pika 2.03 Pagesat

a) Përveç kur BERZH-i bie dakord ndryshe, shumat për t'u disbursuar nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje, paguhet drejtpërdrejt në llogarinë e Konsulentit përkatës, siç përcaktohet në faturën përkatëse. BERZH-i kryen pagesa vetëm nëpërmjet pagesës elektronike në një llogari bankare të mbajtur në emër të Konsulentit dhe që ndodhet në shtetin e vendbanimit të Konsulentit.

b) Nëse afati i caktuar për një pagesë, sipas kësaj Marrëveshjeje, bie në një ditë që nuk është Ditë Pune, atëherë kjo pagesë do të bëhet e kërkueshme në Ditën e ardhshme pasuese të Punës.

c) Çdo shumë që mund të bëhet e kërkueshme për t'u paguar ndaj BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje, paguhet menjëherë, pa kompensim ose kundërpretendim, nga fondet e disponueshme në dollarë amerikanë, për vlerën në datën e pagesës, në llogarinë që BERZH-i, herë pas here, mund të përcaktojë duke njoftuar Marrësin dhe Entin e Projektit. Të gjitha pagesat e kërkueshme ndaj BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk duhet të kenë dhe përfshijnë, dhe pa zbritje ose mbajtje për ose për shkak të ndonjë takse, tatimi, tarife apo pagese të çfarëdoq natyre.

Pika 2.04 Taksat dhe Tatimet

a) Marrësi ose Enti i Projektit paguajnë, sipas rastit dhe kur është e kërkueshme, të gjitha Taksat që vendosen ndaj tij dhe të pagueshme për ose në lidhje me ekzekutimin, publikimin, dorëzimin, regjistrimin ose noterizimin e kësaj Marrëveshjeje ose çdo dokumenti tjetër të lidhur me këtë Marrëveshje.

b) Marrësi dhe Enti i Projektit pranojnë dhe bien dakord se asnjë pjesë e sete ardhurave të Grantit nuk përdoret, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për të paguar ndonjë Taksë, qoftë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në Shqipëri ose diku tjetër.

c) Nëse ndonjë taksë e tërthortë (duke përfshirë TVSH-në) është e pagueshme në lidhje me një Kontratë Konsulente:

i. Enti i Projektit informon BERZH-in, sa më shpejt që është e mundur, në mënyrë të arsyeshme;

ii. Enti i Projektit i paguan drejtpërdrejt Konsulentit një shumë të barabartë me taksat e tilla të tërthorta (duke përfshirë TVSH-në); dhe

iii. në çdo Kërkesë për Disbursim, Enti i Projektit vërteton se ka paguar një shumë të barabartë me taksa të tilla të tërthorta për fatura të mëparshme të Konsulentit dhe merr përsipër, të paguajë Taksën e tërthortë (duke përfshirë TVSH-në) për faturën aktuale.

Neni III **Kushtet Paraprake**

Pika 3.01 Pagesa e Parë e Grantit

Detyrimi i BERZH-it për të kryer Pagesën e parë të Grantit është objekt i përmbushjes paraprake, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in ose heqjes dorë të këtyre kushteve paraprake:

- a) BERZH-i ka marrë një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të ekzekutuar sipas rregullave;
- b) BERZH-i ka marrë një certifikatë për mbajtje detyre dhe autoriteti kryesisht në formularin e Pasqyrës B (*Formulari i Shkresës që Cakton Nënshkruesit e Autorizuar*).
- c) BERZH-i ka marrë kopje të certifikuar të Kontratës së ekzekutuar të Konsulencës.

Pika 3.02 Të Gjitha Pagesat e Grantit

Detyrimi i BERZH-it për të kryer ndonjë Pagesë të Grantit është gjithashtu objekt i përmbushjes, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in ose heqjes dorë të kushteve që në datën e aplikimit të Entit të Projektit për një Pagesë të tillë dhe në datën e këtij Disbursimi:

- a) Marrëveshja e Huas është në fuqi dhe efekt të plotë dhe Marrësi (dhe, kur është e zbatueshme, Enti i Projektit) është në përputhje me të gjitha detyrimet e saj në cilësinë e tij si Huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas;
- b) përfaqësimet dhe garancitë e bëra ose të konfirmuara nga Marrësi dhe Enti i Projektit, sipas rastit, në këtë Marrëveshje janë të vërteta në dhe prej asaj date kanë të njëjtin efekt sikur këto përfaqësime dhe garanci të ishin bërë në dhe nga ato data;
- c) asnjë prej rasteve të përshkruara në pikën 6.02 (a) (*Pezullimi ose Anulimi i Pagesave*) nuk ka ndodhur dhe nuk vijon të ndodhë;
- d) nuk duhet të ketë ndodhur asnjë rast që, në opinionin e arsyeshëm të BERZH-it, mund të ketë efekt negativ material të Marrësi, Enti i Projektit ose Projekti;
- e) BERZH-i ka marrë në kohë Kërkesën për Pagesë nga Enti i Projektit;
- f) BERZH-i ka marrë një kopje të certifikuar të çdo Kontrate Konsulente të ekzekutuar dhe çdo fature për të cilën është kërkuar Pagesa;
- g) BERZH-i ka marrë konfirmim nga Enti i Projektit, që:
 - i. Shërbimet e Konsulencës janë ofruar ose kryer në mënyrë të pranueshme në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratën përkatëse të Konsulencës;
 - ii. çdo faturë është e drejtë dhe e saktë, dhe korrespondon me shumën e përcaktuar në Kontratën përkatëse të Konsulencës; dhe
- h) BERZH-i ka marrë dokumente të tjera që BERZH-i, në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojë, duke përfshirë: i. evidenca të tilla në lidhje me përdorimin e propozuar të të ardhurave të Pagesës; dhe ii. evidenca të përdorimit të të ardhurave të Pagesës/ave të mëparshme.

Neni IV **Detyrimet e Palëve**

Nëse BERZH-i nuk bie dakord ndryshe me shkrim:

Pika 4.01 Kryerja e Biznesit dhe Veprimeve

Enti i Projektit:

- a) ruan ekzistencën e korporatës së vet, në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi; dhe
- b) kryen biznesin dhe veprimet e saj në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare, teknike dhe tregtare.

Pika 4.02 Përdorimi i Grantit

Marrësi dhe Enti i Projektit e përdorin Grantin rigorozisht dhe vetëm për të financuar Zërat e Financuar nga Granti.

Pika 4.03 Marrëveshja e Huas

Marrësi, kur është e zbatueshme dhe Enti i Projektit, kur është e zbatueshme:

- a) përmbush në çdo kohë detyrimet në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas;
- b) siguron që çdo pjesë e Projektit të financuar nga Granti të kryhet në përputhje me detyrimet mjedisore dhe sociale të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas;
- c) siguron që Plani i Zbatimit të Projektit, i dorëzuar dhe miratuar nga BERZH-i, në përputhje me Marrëveshjen e Huas, të përfshijë Zërat e Financuar nga Granti dhe Kontratat e Konsulencës;
- d) siguron që aktivitetet dhe përgjegjësitë e Njesisë së Zbatimit të Projektit të përfshijnë prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti dhe zbatimin e Financimit të Grantit;
- e) merr dhe mban në fuqi (ose, kur është e përshtatshme, rinovon) të gjitha autorizimet e kërkuara, në përputhje me Marrëveshjen e Huas ose ndryshe për Projektin, dhe përmbush dhe respekton të gjitha kushtet dhe kufizimet e përfshira ose të vendosura për Marrësin nga këto Autorizime;

Pika 4.04 Prokurimi

- a) Enti i Projektit siguron që çdo Zë i Financuar nga Granti të prokurohet në përputhje me Politikën dhe Rregullat e Prokurimit.
- b) Të gjitha kontratat u nënshtrohen procedurave të shqyrtimit të përcaktuara në Politikën dhe Rregullat e Prokurimit të BERZH-it dhe shqyrtimit paraprak nga BERZH-i.
- c) Nëse, në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, BERZH-i përcakton se Marrësi, Enti i Projektit, një furnitor, nënfurnitor, kontraktues, nënkontraktues, koncesionar, konsulent ose nënkonsulent në konkurrencë për ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate, në lidhje me Projektin ose çdo transaksion të parashikuar në të, ka kryer ndonjë Praktikë të Ndaluara, BERZH-i mund ta shpallë këtë kontratë ose transaksion të papërshtatshëm për financim dhe BERZH-i mund të ndërmarrë çdo Veprim Zbatimi dhe çdo Veprim Publikimi (sipas përkufizimeve në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit).
- d) Enti i Projektit përfshin dispozitat në dokumentet e tenderit dhe çdo kontratë, në lidhje me Projektin ose çdo transaksion të parashikuar në të:
 - i. duke deklaruar se furnitorët, nënfurnitorët, kontraktuesit, nënkontraktuesit, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët nuk duhet dhe nuk autorizojnë ose lejojnë asnjë nga nëpunësit, drejtorët, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët, agjentët ose përfaqësuesit e tyre që të përfshihen në ndonjë Praktikë të Ndaluara, në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar në të; dhe
 - ii. duke njoftuar furnitorët, nënfurnitorët, kontraktuesit, nënkontraktuesit, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët, se BERZH-i gëzon të drejtën që të përdorë Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, duke përfshirë çdo Veprim Zbatimi dhe Veprim Publikimi në drejtim të pretendimeve për Praktikën e Ndaluara, në lidhje me Projektin ose transaksionet e parashikuara në të.

Pika 4.05 Kontratat

- a) Enti i Projektit:
 - i. siguron që të gjithë Kontratat e Konsulencës përfshijnë dispozita të pranueshme për BERZH-in, duke kërkuar që asnjë Konsulent të mos përfshihet në ndonjë Praktikë të Ndaluara ose Shpagim;
 - ii. i vë në dispozicion BERZH-it një kopje të certifikuar të të gjitha Kontratave të ekzekutuara jo më vonë se dhjetë ditë nga data e tyre.
- b) Enti i Projektit nuk kryen asnjë ndryshim material (duke përfshirë ndonjë vendim lidhur me caktimin ose nënkontraktimin) për një Kontratë Konsulence pa pëlqimin paraprak me shkrim të BERZH-it (i cili nuk do të tërhiqet në mënyrë të paarsyeshme). Në çdo rast, Enti i Projektit e njofton BERZH-in për të gjithë ndryshimin material në Kontratën e Konsulencës.

Pika 4.06 Siguricioni

Enti i Projektit mban siguracionin e duhur, në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare, teknike dhe tregtare në Shqipëri.

Pika 4.07 Evidencat dhe Raportet Financiare

Marrësi, nëpërmjet Entit të Projektit:

a) mban libra të veçantë kontabël dhe evidenca të tjera lidhur me Grantin, në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranueshme për BERZH-in dhe të zbatueshme në vazhdimësi;

b) siguron që autorizimi i dhënë Audituesve në përputhje me Marrëveshjen e Huas, për të komunikuar drejtpërdrejt me BERZH-in, të zgjerohet me informacion të kërkuar nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me Grantin; dhe

c) mban dokumente dhe evidenca të kontabilitetit financiar lidhur me veprimtaritë e financuara nga Granti për të paktën 5 vjet nga data e përfundimit ose zgjidhjes së Kontratës përkatëse të Konsulencës.

Pika 4.08 Dhënia e Informacionit

a) Marrësi pranon se në marrjen e informacionit në përputhje me Marrëveshjen e Huas, BERZH-i, në cilësinë e tij si Huadhënës, mund të përdorë dhe bazohet në këtë informacion në cilësinë e tij si ofrues i Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në masën që ky informacion nuk i jepet BERZH-it, në përputhje me Marrëveshjen e Huas, Enti i Projektit i siguron BERZH-it, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in:

i. informacion të detajuar lidhur me prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti, Kontratat e Konsulencës, Konsulentët dhe përdorimin e Grantit;

ii. informacion të mjaftueshëm për t'i mundësuar BERZH-it që të gjurmojë përdorimin e Grantit (që dallon nga Huaja); dhe

iii. informacione të tjera që lidhen me Marrësin, Entin e Projektit, Projektin dhe transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje, të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga BERZH-i.

c) Sa më shpejt që të jetë në dispozicion, por në çdo rast brenda 30 ditësh pas përfundimit ose zgjidhjes së secilës Kontratë Konsulente, Enti i Projektit i paraqet BERZH-it një raport përfundimtar në lidhje me përdorimin e Grantit.

d) Sa më shpejt që të jetë në dispozicion, por në çdo rast brenda 30 ditësh pas përfundimit të Projektit, Enti i Projektit i paraqet BERZH-it një raport përfundimtar, duke identifikuar përdorimin e Grantit.

e) Me kërkesë, Enti i Projektit i paraqet menjëherë BERZH-it, evidenca të pranueshme që Zërat e Financuar nga Granti janë siguruar në mënyrën e duhur.

f) Menjëherë me ndodhjen e ndonjë rasti të përshkruar në pikën 6.02 (a) (*Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve*), Marrësi, nëpërmjet Entit të Projektit, e njofton BERZH-in për të, duke specifikuar natyrën e këtij rasti dhe çdo hap që Marrësi po ndërmerret për ta korrigjuar atë.

g) Marrësi dhe Enti i Projektit e njoftojnë BERZH-in në kohë, nëse Marrësi ose Enti i Projektit marrin informacion lidhur me një shkelje të pikës 4.09 (*Mashtrimi dhe Korrupsioni*) ose pikës 5.01(b) (*Deklaratat*), ose nëse ndonjë institucion financiar ndërkombëtar ka vendosur sanksione mbi Marrësin ose Entin e Projektit për ndonjë Praktikë të Ndaluar. Nëse BERZH-i e njofton Marrësin ose Entin e Projektit për shqetësimin e tij se ka pasur shkelje të pikës 4.09 ose 5.01(b), Marrësi dhe Enti i Projektit bashkëpunojnë në mirëbesim me BERZH-in dhe përfaqësuesit e tij për të konstatuar nëse ka ndodhur një shkelje e tillë.

h) Enti i Projektit njofton BERZH-in në kohë për pezullimin ose zgjidhjen, ose për ndonjë rast që mund të ketë sjellë pezullimin ose zgjidhjen e Kontratës së Konsulencës.

i) Enti i Projektit i jep në kohë BERZH-it informacione të tjera të ngjashme kur BERZH-i ose Donatori mund t'i kërkojnë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Pika 4.09 Mashtrimi dhe Korrupsioni

As vetë Marrësi, as Enti i Projektit nuk përfshihen ose autorizojnë ose lejojnë që ndonjë prej nëpunësve të tyre përkatës, drejtorëve, punonjësve të autorizuar, bashkëpunëtorëve, agjentëve ose përfaqësuesve, ose Konsulentëve të përfshihet në ndonjë Praktikë të Ndaluar ose Shpagim, në lidhje me Projektin, Grantin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje.

Pika 4.10 Vizibiliteti

a) Marrësi, nëpërmjet Entit të Projektit, merr masat e duhura për të bërë publike në publikimet, komunikimet, si dhe mediat përkatëse, faktin që ndër të tjera, projekti ka marrë financim nga donatorët.

b) Emri, shkurtesa dhe logoja e BERZH-it, si dhe emrat, shkurtesat dhe logot (nëse ka) të Donatorëve janë marka shërbimi të regjistruara, të cilat Marrësi nuk i riprodhon pa lejen e shprehur me shkrim të BERZH-it.

Pika 4.11 Inspektimi dhe auditimi

Marrësit dhe Enti i Projektit i mundësojnë BERZH-it, Donatorëve dhe përfaqësuesve të tyre të autorizuar, me kërkesë të BERZH-it, që të:

- i. vizitojnë objektet dhe kantieret e ndërtimit në lidhje me Projektin;
- ii. inspektojnë llogaritë dhe evidencat në lidhje me Projektin, performancën kësaj Marrëveshjeje dhe/ose Kontratat e Konsulencës;
- iii. lejojnë auditimin e këtyre llogarive nga auditues të caktuar nga BERZH-i; dhe
- iv. për këto qëllime, të zhvillojnë takime dhe diskutime me përfaqësuesit dhe punonjësit e Marrësit dhe Entit të Projektit, siç BERZH-i mund ta çmojë të nevojshme dhe të përshtatshme.

Neni V

Përfaqësimet dhe Garancitë

Pika 5.01 Përfaqësimet

a) Nëse ndonjë përfaqësim dhe garanci bëhet nga Marrësi në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas, ato përsëriten nga Marrësi sikur të parashikohen plotësisht këtu, sikur referencat për “Huamarrësin” të lexoheshin si referenca për “Marrësin” dhe termi “Marrëveshje Financimi” të përkufizohej për të përfshirë këtë Marrëveshje.

b) Marrësi dhe Enti i Projektit garantojnë dhe deklarojnë më tej se as Marrësi, as Enti i Projektit, as ndonjë nëpunës, drejtor, punonjës i autorizuar, bashkëpunëtor, agjent ose përfaqësues i Marrësit ose Entit të Projektit nuk ka kryer ose është përfshirë në ndonjë Praktikë të Ndaluar ose Shpagim, në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje.

Pika 5.02 Pranimi dhe përsëritja

a) Marrësi dhe Enti i Projektit pranojnë secili se kanë bërë dhe përsëritur të gjitha përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në pikën 5.01 (*Përfaqësimet*), me qëllim që BERZH-i të lidhë këtë Marrëveshje dhe se BERZH-i ka lidhur këtë Marrëveshje mbi bazën e dhe duke u mbështetur plotësisht në secilën prej këtyre përfaqësimeve dhe garancive. Marrësi dhe Enti i Projektit garantojnë se nuk kanë njohuri për ndonjë fakt ose çështje shtesë, mosveprimi i të cilave e bën ndonjë prej këtyre përfaqësimeve dhe garancive të pavërteta.

b) Përfaqësimet dhe garancitë e parashikuara në pikën 5.01 (*Përfaqësimet*) konsiderohen të përsëritura me paraqitjen e çdo Kërkese për Pagesë dhe në çdo datë Pagesë, me përjashtim të ndonjë përfaqësimi ose garancie që specifikon se është dhënë “në datën e kësaj Marrëveshjeje”.

Neni VI

Pezullimi dhe Anulimi

Pika 6.01 Anulimi nga Marrësi

Marrësi, në çdo kohë, jo më parë se njoftimi paraprak me shkrim prej 40 ditësh për BERZH-in, mund të anulojë tërësisht ose pjesërisht çdo pjesë të padisbursuar të Grantit; me kushtin që BERZH-i të jetë i bindur se financimi i duhur do të mbetet në dispozicion për t'i mundësuar Marrësit ta përfundojë Projektin në përputhje me Planin e Zbatimit të Projektit. Çdo njoftim për anulim nga Marrësi është i pakthyeshëm dhe detyrues, dhe shumat e Grantit që janë anuluar nga Marrësi mund të mos rikthehen.

Pika 6.02 Pezullimi ose Anulimi i Pagesave

a) BERZH-i, me anë të një njoftimi me shkrim për Marrësin dhe Entin e Projektit, mund të pezullojë ose anulojë të drejtën e Entit të Projektit për të kërkuar të gjitha ose një pjesë të ndonjë

shume të padisbursuar të Grantit, nëse ka ndodhur ose vazhdon të ndodhë ndonjë nga rastet e mëposhtme:

i. BERZH-i ka pezulluar disbursimet ose ka anuluar të gjitha ose një pjesë të Huas, ose BERZH-i ka të drejtën të pezullojë disbursimet ose të anulojë të gjitha ose një pjesë të Huas në përputhje me Marrëveshjen e Huas;

ii. Marrësi, në cilësinë e tij si huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas, ka anuluar tërësisht ose pjesërisht çdo pjesë të padisbursuar të Huas;

iii. Marrëveshja e Huas ose Marrëveshja e Projektit pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë, ose është zgjidhur;

iv. Marrësi ose Enti i Projektit, sipas rastit, nuk përmbushin ndonjë nga detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes së Huas;

v. ka ndodhur ose vazhdon të ndodhë ndonjë rast i specifikuar në Pikën 4.01 (*Pezullimi*) të Marrëveshjes së Huas dhe BERZH-i ka deklaruar që e gjitha ose ndonjë pjesë e Huas është e kërkueshme dhe e pagueshme;

vi. është siguruar financim alternativ për Projektin që çon në financim të dyfishtë (qoftë tërësisht ose pjesërisht);

vii. është ose është bërë e paligjshme në çdo juridiksion që BERZH-i të bëjë, mbajë ose financojë Financimin me Grant, ose të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

viii. Kontrata/t e Konsulencës është/janë pezulluar ose zgjidhur;

ix. një përfaqësim ose garanci e dhënë nga Marrësi, në lidhje me këtë Marrëveshje ka qenë e pasaktë ose çorientuese në aspektin material; ose

x. informacioni i përfshirë në një Kërkesë Pagese është i pavërtetë, i pasaktë ose çorientues në ndonjë aspekt material.

b) Me nxjerrjen e njoftimit për pezullim nga BERZH-i në zbatim të paragrafit “a”, më sipër, e drejta e Entit të Projektit për të kërkuar Pagesa të tjera pezullohet ose anulohet, siç parashikohet në njoftim. Ushtrimi nga BERZH-i i së drejtës së pezullimit nuk e pengon BERZH-in që të ushtrojë të drejtën e tij të anulimit, siç parashikohet në këtë Pikë, qoftë për të njëjtën apo arsye tjetër, dhe nuk kufizon asnjë të drejtë tjetër të BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas ose ndonjë Marrëveshjeje tjetër Financimi lidhur me Projektin.

Pika 6.03 Rastet e Rimbursimit

a) Rasti dhe ndodhia e mëposhtme përbën një Rast Rimbursimi, sipas kësaj Marrëveshjeje: ka ndodhur ose vazhdon të ndodhë ndonjë nga rastet e përshkruara në pikën 6.02(a) (*Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve*) dhe nëse mund të rregullohet, ky rast ka vazhduar për një periudhë 30-ditore, pasi BERZH-i ka dhënë njoftim në lidhje me të;

b) Nëse një Rast Rimbursimi ndodh ose vazhdon të ndodhë, BERZH-i, nëpërmjet njoftimit të Marrësit ose Entit të Projektit, mund të kërkojë që Marrësi ose Enti i Projektit të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Grantit, dhe të paguajë çdo shumë tjetër të shkaktuar – ose të pagueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje. Pavarësisht ndonjë pike në këtë Marrëveshje, shumat e kërkuar nga BERZH-i do të bëhet, ose: i. e kërkueshme dhe e pagueshme me kërkesë; ose ii. e kërkueshme dhe e pagueshme menjëherë pa njoftim të mëtejshëm dhe pa deklaratë, kërkesë apo kundërshtim të çfarëdo lloji, nga të cilat hiqet dorë shprehimisht nga Marrësi.

c) Pavarësisht ndonjë pike në këtë Marrëveshje, nëse BERZH-i, në çdo kohë, konstaton mospërputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit ku Marrësi ose Enti i Projektit apo Konsulenti është konstatuar i përfshirë në një Praktikë të Ndalar ose Shpagim gjatë konkurrimit ose ekzekutimit të një Kontrate Konsulence, BERZH-i, nëpërmjet njoftimit të Marrësit ose Entit të Projektit, mund të kërkojë që Marrësi ose Enti i Projektit të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Financimit me Grant dhe e njëjta pjesë të bëhet menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme me kërkesë.

Neni VII Të ndryshme

Pika 7.01 Zbatueshmëria; Afati dhe Zgjidhja

a) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi datën e njoftimit me shkrim të Marrësit për BERZH-in, që informon se:

- i. kjo Marrëveshje është miratuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë; dhe
- ii. janë realizuar të gjitha procedurat e kërkuara nga legjislacioni vendës i Republikës së Shqipërisë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri kur Marrësi dhe Enti i Projektit të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk është zgjidhur më herët në përputhje me kushtet e saj.

b) BERZH-i, në diskrecionin e tij, mund të zgjidhë këtë Marrëveshje në çdo kohë, por duke njoftuar me shkrim Marrësin dhe Entin e Projektit, jo më vonë se 40 ditë para.

c) Pas zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje sipas paragrafit “b” më sipër, Enti i Projektit merr hapa të menjëhershëm për të reduktuar humbjet dhe për të mbajtur në minimum shpenzimet e mëtejshme, sipas Kontratave të Konsulencës.

Pika 7.02 Mbetja në Fuqi pas Marrëveshjes

Dëmshtëpërblimet dhe garancitë e Marrësit dhe Entit të Projektit dhe dispozitat e pikës 2.03 (*Pagesat*), pikës 4.07 (*Evidencat dhe raportet financiare*), pikës 4.08 (*Dhënia e informacionit*), pikës 4.11 (*Inspektimi dhe auditimi*), pikës 6.03(c) (*Rastet e Rimbursimit*), kësaj pike 7.02 (*Mbetja në fuqi pas Marrëveshjes*), pikës 7.05 (*Gjuba angleze*), pikës 7.07 (*Përgjegjësia dhe dëmshtëpërblimi*), pikës 7.08 (*Legjislacioni Rregullues*) dhe pikës 7.09 (*Arbitrazhi dhe juridiksioni*) mbeten në fuqi për shlyerjen e Grantit dhe zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje.

Pika 7.03 Marrëveshja e Plotë; Ndryshimi dhe heqja dorë

a) Kjo Marrëveshje dhe dokumentet e përmendura në të përbëjnë detyrimin e plotë të Palëve, në lidhje me objektin dhe zëvendësojnë çdo shprehje të mëparshme të qëllimit apo mirëkuptimeve (të shprehura apo të nënkuptuara me gojë ose me shkrim), në lidhje me këtë transaksion.

b) Çdo ndryshim i termave ose i kushteve të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë këtë pikë 7.03) bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Palët. Palët mund të bien dakord që ta anulojnë ose ndryshojnë këtë Marrëveshje pa pëlqimin e ndonjë personi që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje.

c) Çdo heqje dorë nga ana e BERZH-it lidhur me ndonjë prej këtyre termave ose kushteve apo me pëlqimin e dhënë nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga BERZH-i. Në rast se BERZH-i heq dorë nga një kusht për ndonjë Pagesë, atëherë, duke pranuar shumën e kësaj Pagese, Enti i Projektit (dhe, në rastet e zbatueshme, Marrësi) konsiderohet se pajtohet me të gjitha termat dhe kushtet e kësaj heqjeje dorë.

Pika 7.04 Njoftimet

a) Çdo komunikim administrativ i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje me BERZH-in apo Marrësin, ose Entin e Projektit bëhet me shkrim dhe mund t'i dërgohet me postë elektronike Palës marrëse.

b) Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër joadministrativ i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje me BERZH-in ose Marrësin apo Entin e Projektit, bëhet me shkrim. Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, këto njoftime, kërkesa apo komunikime të tjera konsiderohen se janë dhënë apo bërë siç duhet kur i janë dorëzuar dorazi, me postë ajrore apo faksimile palës së cilës i kërkohet ose lejohet t'i jepet ose t'i bëhet në adresën e kësaj pale të specifikuar më poshtë ose në një adresë tjetër që përcakton pala, duke njoftuar palën që jep ose bën njoftim, aplikim apo komunikim tjetër.

Për Marrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për Entin e Projektit:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Rruga "Sami Frashëri", 10

Tiranë 1001 Shqipëri

Në vëmendje të: Z. Dritan Agolli, Drejtor Ekzekutiv

Email: adf@albanianidf.org

Faks: +355 4 2234 885

Për BERZH-in:**Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**

One Exchange Square

Londër EC2A 2JN

United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Ilir Basha

Email: bashai@ebrd.com

Faks: +355 4 2230 580

Pika 7.05 Gjuha angleze

Kjo Marrëveshje është përgatitur dhe ekzekutuar në gjuhën angleze. Çdo dokument që jepet dhe komunikimet që shkëmbehen sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen në gjuhën angleze ose, në rast të përdorimit të një gjuhe tjetër, shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën angleze nga Marrësi ose Enti i Projektit, sipas rastit. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje për gjuhën, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Pika 7.06 Të drejtat, mjetet juridike dhe heqja dorë

a) Të drejtat dhe mjetet juridike të BERZH-it, në lidhje me ndonjë deklaratë të rreme ose shkelje të garancisë nga ana e Marrësit apo Entit të Projektit nuk do të cenohen nga asnjë hetim nga ose në emër të BERZH-it për çështjet e Marrësit ose Entit të Projektit, nga ekzekutimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ose nga ndonjë akt apo veprim tjetër që mund të bëhet nga ose në emër të BERZH-it, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe që, përveç kësaj pike 7.06, mund të cenojnë këto të drejta ose mjete juridike

b) Asnjë mënyrë e trajtimit ose heqjes dorë nga ana e BERZH-it në lidhje me ndonjë kusht të Pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk dëmton asnjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të BERZH-it, në lidhje me ndonjë kusht tjetër të Pagesës ose të interpretohet se është heqje dorë prej tij.

c) Asnjë veprim i BERZH-it për sa i përket ndonjë Pagese nuk mund të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të BERZH-it në lidhje me ndonjë Pagesë tjetër. Pa u kufizuar te sa më sipër, e drejta e BERZH-it për të kërkuar përputhshmëri me ndonjë kusht sipas kësaj Marrëveshjeje që mund të hiqet dorë nga BERZH-i, në lidhje me ndonjë Pagesë, përveç nëse njoftohet ndryshe për Marrësin nga BERZH-i, ruhet shprehimisht për qëllimet e ndonjë Pagese pasuese.

d) Asnjë mënyrë e trajtimit dhe asnjë vonesë në ushtrim, ose mosveprim për ushtrim të ndonjë të drejte, fuqie apo mjeti juridik që i akordohen BERZH-it pas ndodhjes së ndonjë Rasti Rimbursimi ose ndryshe sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të dëmtojë asnjë të drejtë, fuqi apo mjet juridik, ose nuk do të interpretohet si heqje dorë prej tij ose pajtim i heshtur me të. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, fuqie apo mjeti juridik nuk mund të pengojë ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tij, ose ushtrimin e ndonjë të drejte, fuqie ose mjeti tjetër juridik. Asnjë veprim i BERZH-it, në lidhje me ndonjë Rast Rimbursimi nuk ndikon ose dëmton ndonjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të BERZH-it, në lidhje me ndonjë Rast tjetër Rimbursimi apo rast tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

e) Të drejtat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë Marrëveshje janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive të të drejtave ose mjeteve të tjera juridike, pavarësisht nëse parashikohen nga ligji në fuqi apo ndryshe.

Pika 7.07 Përgjegjësia dhe Dëmshpërblimi

a) BERZH-i nuk jep asnjë deklaratë apo garanci dhe nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi në lidhje me Shërbimet e Konsulencës ose Konsulentin. Secila Palë:

i. pranon dhe bie dakord që nuk do të jetë përgjegjëse ndaj tjetrës për asnjë përgjegjësi, detyrim, humbje, dëm (qoftë të drejtpërdrejtë, të tërthortë, financiar, ekonomik apo me pasojë, pavarësisht nëse është shkaktuar ose jo nga veprimi i pakujdesshëm ose mosveprimi i BERZH-it), gjobë, pretendim, veprim, taksë, tatim, padi, kosto dhe shpenzim (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e konsulencës ligjore apo kostot e hetimit) në lidhje me Konsulentin (duke përfshirë përzgjedhjen, angazhimin ose monitorimin e Konsulentit) ose me Shërbimet e Konsulencës (duke përfshirë si pasojë e Marrësit dhe/ose Entit të Projektit që përdor ose bazohet në shërbimet e Konsulentit), ose që lind nga ose në lidhje me Kontratën e Konsulencës; dhe

ii. liron dhe shkarkon Palët e tjera nga çdo pretendim, e drejtë, borxh, përgjegjësi, kërkesë dhe veprim të çfarëdo lloji ose natyre që mund të ketë aktualisht apo në të ardhmen ndaj palës tjetër që lind nga ose në lidhje me ndonjë veprim ose mosveprim të marrë ose bërë (ose që nuk është marrë ose bërë) nga Konsulenti në ofrimin e Shërbimeve të Konsulencës.

b) Marrësi dhe Enti i Projektit marrin përsipër ta konsiderojnë BERZH-in të padëmshëm ndaj çdo veprimi, padie, pretendimi, kërkesë, humbjeje, tarife, dëmi, kostoje dhe shpenzimi, takse, gjobe dhe detyrimi tjetër të shkaktuar dhe/ose pësuar nga BERZH-i, i cili rrjedh nga, prej ose në lidhje me zbatimin e Projektit dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që Banka të mos ketë asnjë të drejtë për dëmshpërblim, sipas kësaj Marrëveshjeje për veprimet e saj të pakujdesshme.

Pika 7.08 Legjislacioni Rregullues

Kjo kontratë rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin anglez. Çdo detyrim jokontraktues që lind nga ose lidhur me këtë Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin anglez.

Pika 7.09 Arbitrazhi dhe Juridiksioni

a) Çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim që lind nga ose në lidhje, me: i. këtë Marrëveshje; ii. shkelje, zgjidhje ose pavlefshmëri të saj; ose iii. ndonjë detyrim jokontraktues që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, zgjidhet nga arbitrazhi në përputhje me Rregullat e UNCITRAL-it për Arbitrazhin në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje ("Rregullat e UNCITRAL-it"). Ka një arbitër dhe autoriteti i caktuar është LCIA (Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar të Londrës). Selia dhe vendi i arbitrazhit është Londër, Angli dhe gjuha angleze përdoret gjatë gjithë procedurave të arbitrazhit. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë, sipas Aktit të Arbitrazhit të vitit 1996 ose për të apeluar ndonjë vendim arbitrazhi ose për të kërkuar përcaktimin e një çështje ligjore paraprake nga gjykatat e Anglisë. Gjykata e Arbitrazhit nuk autorizohet të japë dhe Marrësi dhe Enti i Projektit bien dakord se nuk kërkojnë nga ndonjë autoritet gjyqësor asnjë masë të menjëhershme ose lehtësim përpara vendimit ndaj BERZH-it, pavarësisht parashikimeve të Rregullave të UNCITRAL-it. Gjykata e Arbitrazhit ka autoritetin të shqyrtojë dhe të përfshijë në çdo procedurë, vendim apo vendim gjykate çdo mosmarrëveshje tjetër të paraqitur para saj nga BERZH-i (por jo nga palë të tjera) në atë masë që ky konflikt lind nga kjo Marrëveshje, Marrëveshja e Huas ose ndonjë Marrëveshje tjetër Financimi, por, si subjekt i pararendësve, asnjë palë ose mosmarrëveshje tjetër nuk përfshihet ose integrohet me procedurat e arbitrazhit. Në çdo procedurë arbitrazhi, vërtetimi i BERZH-it për çdo shumë të detyrueshme ndaj BERZH-it sipas kësaj Marrëveshjeje është dëshmi *prima facie* e kësaj shume.

b) Pavarësisht paragrafit "a" më sipër, kjo Marrëveshje dhe Marrëveshjet e tjera të Financimit dhe çdo e drejtë e BERZH-it që lind ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo ndonjë Marrëveshje tjetër Financimi, në diskrecionin e BERZH-it, mund të zbatohen nga BERZH-i në gjykatat e Shqipërisë ose në ndonjë gjykatë tjetër që ka juridiksion. Për interes të BERZH-it, Marrësi dhe Enti i Projektit paraqesin në mënyrë të pakthyeshme në juridiksionin joekskluziv të gjykatave të Anglisë në lidhje me çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim (duke përfshirë në lidhje me detyrimet jokontraktuese) që lind ose në lidhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë Marrëveshje tjetër Financimi, ose shkeljen, zgjidhjen apo pavlefshmërinë e tyre. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk cenon të drejtën e BERZH-it për të filluar veprime ose procedura ligjore ndaj Marrësit dhe Entit të Projektit, sipas mënyrës së autorizuar nga ligjet e juridiksionit përkatës. Fillimi nga BERZH-i i veprimeve ose procedurave ligjore në një ose më shumë juridiksione nuk e pengon BERZH-in që të fillojë veprime ose procedura ligjore në juridiksione të tjera, qoftë njëkohësisht

apo jo. Marrësi dhe Enti i Projektit heqin dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo kundërshtim që mund të kenë aktualisht ose më vonë të çfarëdolloj arsyeje për pranimin e vendit të veprimeve ose procedurave ligjore dhe çdo pretendim që mund të kenë aktualisht ose më vonë se këto veprime ose procedura ligjore janë paraqitur në një gjykatë të përshtatshme.

Pika 7.10 Pasuesit dhe Drejtëmarrësit; Të Drejtat e Palëve të Treta

a) Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme dhe në dobi të pasuesve dhe drejtëmarrësve përkatës të Palëve, me përjashtim që as Marrësi dhe as Enti i Projektit nuk mund të caktojnë ose transferojnë të gjitha ose një pjesë të të drejtave apo detyrimeve të tyre, sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të BERZH-it.

b) Me përjashtim të sa parashikohet në pikën “a” më sipër, asnjë nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me zbatimin e projektit dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje nuk synon të zbatohet nga palë të treta, dhe dispozitat e Kontratës (Të drejtat e Palëve të Treta) Akti i vitit 1999 përjashtohen dhe nuk janë të zbatueshme.

Pika 7.11 Nxjerrja e të Dhënave

a) BERZH-i mund të nxjerrë ato dokumente, informacione dhe evidenca që kanë lidhje me Marrësin dhe Entin e Projektit dhe këtë transaksion (duke përfshirë kopjet e kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo marrëveshjeje tjetër të parashikuar këtu), që BERZH-i i gjykon të përshtatshme për çdo qëllim në lidhje me çdo mosmarrëveshje që përfshin Marrësin dhe/ose Entin e Projektit, për qëllim të ruajtjes ose zbatimit të ndonjë prej të drejtave të BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të parashikuar në këtë Marrëveshje, ose për qëllim të arkëtimit të shumës që i detyrohet BERZH-it.

b) BERZH-i mund t'i njoftojë Donatorit dokumente, informacione dhe evidenca (duke përfshirë një kopje të kësaj Marrëveshjeje) të siguruar nga Marrësi ose Enti i Projektit, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe nga Marrësi (dhe, kur është e zbatueshme, nga Enti i Projektit), në cilësinë e tij si huamarrës, sipas kushteve të Marrëveshjes së Huas, siç BERZH-i mund ta gjykojë të përshtatshme.

c) BERZH-i mund të publikojë një përshkrim të çdo Kontrate Konsulence, duke përfshirë emrin dhe kombësinë e Konsulentit dhe çmimin e kontratës.

Pika 7.12 Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në tre kopje, një për secilën palë, ku secili konsiderohet origjinal, por ku të gjitha së bashku përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Në dëshmi sa më sipër, palët e kësaj Marrëveshjeje, me anë të përfaqësuesve të autorizuar posaçërisht prej tyre, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në datën e shënuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

MARRËSI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË, E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nga: _____

Emri: DELINA IBRAHIMAJ

Titulli: MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË 17.6.2022

ENTI I PROJEKTT

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

Nga: _____

Emri: DRITAN AGOLLI

Titulli: DREJTOR EKZEKUTIV

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri: EKATERINA SOLOVOVA

Titulli: DREJTUESE E ZYRËS PËR SHQIPËRINË

PASQYRA A FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM *[Për t'u shtypur me letër me kokë të Marrësit]*

[datë]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Donor Funded Operations (DonorInvoices@ebrd.com)
Për dijeni të: *[vendosni emrin dhe adresën e postës elektronike të OL]*

Lënda: Marrëveshja e Grantit nr. 2021.004131, sipas DTM-së nr. 50123/ TCRS-së nr. 9900/59901

Kërkesë Pagesë nr. _____¹

I/e nderuar z./znj.:

1. Ju lutem referojuni marrëveshjes së grantit, datë [_____] ("Marrëveshja e Grantit") të lidhur ndërmjet *[emri i Marrësit]* ("Marrësi"), *[emri i Entit të Projektit]* ("Enti i Projektit") dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("BERZH").

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen e Grantit kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë dokument.

²³3. Ne kërkojmë Disbursimin e mëposhtëm në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit:

i. Donatori: []

Monedha e pagesës së kërkuar: *[monedha e Fondit]*

Shuma totale (në shifra dhe fjalë): _____

Data e vlerës: [Sa më shpejt që të jetë e mundur, në një datë të zgjedhur nga BERZH-i, në diskrecionin E tij, por jo më vonë se]³ _____⁴

ii. Donatori: []

Monedha e pagesës së kërkuar: *[monedha e Llogarisë]*

Shuma totale (në shifra dhe fjalë): _____

Data e Vlerës: [sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se] _____

⁵⁴4. Lidhur me shumën prej [] për disbursim nga [Fondi], ne konfirmojmë deklaratimet e dhëna në aneksin A (Kontratë Konsulencë nr. *[numri i referencës]*) për këtë Kërkesë Pagesë.

¹ Secili aplikim duhet të numërohet në seri.

² Përfshini shumën e përgjithshme për disbursim nga secili Fond ose Llogari.

³ Nëse Pagesa kërkohet për një datë specifike të vlerës, fshini këtë gjuhë të vendosur në kllapa.

⁴ Kjo datë nuk mund të jetë më herët sesa 10 Ditë Pune, pasi Kërkesa e Pagesës të dorëzohet pranë BERZH-it.

⁵ Përsëritni paragrafin 4 për secilën Kontratë dhe Kontratë Konsulencë.

5. Lidhur me shumën prej [] për disbursim nga [Llogaria], ne konfirmojmë deklaratimet e dhëna në aneksin B (Kontratë Konsulencë nr. [numri i referencës]) për këtë Kërkesë Pagesë.

6. Për qëllime të pikës 3.02 (Të gjitha Pagesat e Grantit) të Marrëveshjes së Grantit, ne përfaqësojmë dhe garantojmë se:⁶

a) Marrëveshja e Huas është në fuqi dhe efekt të plotë, dhe Marrësi (dhe, kur është e zbatueshme, Enti i Projektit) pajtohet me të gjitha detyrimet e saj në cilësinë e tij si huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas;

b) të gjitha kushtet pararendëse për disbursimin e Huas, sipas Marrëveshjes së Huas janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in.

c) deklaratat dhe garancitë e dhëna ose të konfirmuara nga Marrësi dhe Enti i Projektit në këtë Marrëveshje janë të vërteta dhe të sakta në datën e saj, me të njëjtin efekt sikur të ishin bërë deklaratat dhe garanci të tilla në datën e këtij dokumenti;

d) nuk ka ndodhur dhe nuk vijon asnjë Rast Rimbursimi;

e) nuk ka ndodhur asgjë që mund të ketë efekt material negativ për Marrësin, Entin e Projektit ose Projektin; dhe

f) Kontrata e Konsulencës është në efekt dhe fuqi të plotë dhe nuk ka pësuar asnjë ndryshim material.

⁷ Bashkëlidhur kësaj Kërkese Pagesë ndodhet:

⁸a) një kopje e noterizuar e një fature, datë [] nga [emri i Konsulentit] në lidhje me Kontratën e Konsulencës nr. [numri i referencës] [dhe të gjitha dokumentet mbështetëse ⁹], në lidhje me Pagesën që kërkohet nga [Fondi];

b) një kopje e noterizuar e një fature, datë [] nga [emri i Konsulentit] në lidhje me Kontratën e Konsulencës nr. [numri i referencës] [dhe të gjitha dokumentet mbështetëse] në lidhje me Pagesën që kërkohet nga [Llogaria];

c) dokumente të tjerë që ka kërkuar BERZH-i [duke përfshirë: i. dëshmi lidhur me përdorimin e propozuar të të ardhurave të Disbursimit; dhe ii. dëshmi lidhur me përdorimin e të ardhurave nga ndonjë Pagesë të mëparshme].

8. Më lëshimin e kësaj Kërkese Disbursimi, Enti i Projektit autorizon BERZH-in, që të kryejë Disbursimin si më poshtë:

i. për [emri i Konsulentit], në zbatim të Kontratës së Konsulencës nr. [numri i referencës], në shumën prej [] nga [Fondi];

ii. për [emri i Konsulentit], në zbatim të Kontratës së Konsulencës nr. [numri i referencës], në shumën prej [] nga [Llogaria];

në çdo rast në emër të Entit të Projektit.

Me respekt,

Nga: _____

Përfaqësuesi i Autorizuar¹⁰

ANEKSI A KONTRATË KONSULENCE NR. [NUMRI I REFERENCËS]

⁶ Zërat e mëposhtëm duhet të pasojnë paragrafët përkatës në pikën 3.02.

⁷ Zërat e mëposhtëm duhet të pasojnë pikat përkatëse në pikën 3.02.

⁸ Nëse Zërat e Financuar nga Granti prokurohen **në tregun me pakicë** (apo të barasvlershëm me të), nuk kërkohen fatura të Kontratës. Megjithatë, Enti i Projektit siguron dëshminë e blerjes dhe pagesës për këta zëra.

⁹ Nuk kërkohen dokumente mbështetëse për Zërat e Financuar nga Granti, të cilat **financohen në bazë të një shume të vetme**, ku Marrësi i nënshtrohet ruajtjes së evidencave të pagesave dhe dokumenteve mbështetëse siç kërkohet nga kjo Marrëveshje.

¹⁰ Emri i personit që nënshkruan Kërkesën e Pagesës duhet të vendoset në Shkresën e Caktimit të Nënshkruesve të Autorizuar.

Lidhur me shumën prej [] për disbursim nga [Fondi], ne konfirmojmë, se:

a) Të ardhurat nga Pagesa i nevojiten Entit të Projektit rigorozisht dhe vetëm për financimin e kostove të arsyeshme të shpenzimeve të kryera [ose, nëse është rënë dakord me BERZH-in, që do të kryhen] në lidhje me Zërat e Financuar nga Granti të përshkruar në pikën [1(a)] të skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti).

b) Ne iu kemi paraqitur një kopje të noterizuar të Kontratës së ekzekutuar të Konsulencës për [titulli i kontratës], datë [] dhe të lidhur ndërmjet Entit të Projektit [emri i Konsulentit], me numër reference [].

c) Shuma prej [] do të përdoret, si më poshtë: [Marrësi duhet të regjistrojë detajet e përdorimit të propozuar të të ardhurave nga Pagesa].

d) Shërbimet e Konsulencës janë kryer në mënyrë të pranueshme në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratën përkatëse të Konsulencës.

e) Fatura bashkëlidhur është e drejtë dhe e saktë dhe korrespondon me shumën e përcaktuar në Kontratën e Konsulencës me numër reference [].

f) Udhëzimet e pagesës për Konsulentin:

i) Të dhënat e bankës së Konsulentit:

Emri i llogarisë së Konsulentit: _____

Numri i llogarisë së Konsulentit (numri IBAN)¹¹: _____

Emri i bankës së Konsulentit: _____

Kodi SWIFT i bankës së Konsulentit: _____

Adresa e bankës së Konsulentit: _____

ii. Të dhënat e bankës korresponduese të Konsulentit:

Emri i bankës korresponduese:¹² _____

Kodi SWIFT i bankës korresponduese: _____

Adresa e bankës korresponduese: _____

Emri i llogarisë së bankës korresponduese: _____

Numri i llogarisë së bankës korresponduese (numri IBAN)¹³: _____

Referenca: _____

¹⁴g) Vërtetojmë se kemi paguar një shumë të barabartë me të gjitha taksat e tërthorta (duke përfshirë TVSH-në) për të gjitha faturat e mëparshme të secilit prej Konsulentëve dhe me anë të kësaj marrim përsipër të paguajmë Taksën e tërthortë (duke përfshirë TVSH-në) në faturën në të cilën kjo Kërkesë Pageje lidhet brenda [30 ditëve] nga data e kësaj Kërkesë Pageje.

PASQYRA B FORMULARI I SHKRESËS QË CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

[Për t'u shtypur me letër me kokë të Marrësit nga Marrësi]

[data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: []

¹¹ Të gjitha pagesat që nuk kryhen në dollarë amerikanë, duhet të përfshijnë numrin e plotë IBAN (numri ndërkombëtar i llogarisë bankare).

¹² Emri i bankës në Londër.

¹³ Të gjitha pagesat që nuk kryhen në dollarë amerikanë, duhet të përfshijnë numrin e plotë IBAN (numri ndërkombëtar i llogarisë bankare).

¹⁴ Përfshini nëse ndonjë taksë e tërthortë (duke përfshirë TVSH-në) është e pagueshme në lidhje me Kontratën e Konsulencës (shihni pikën 2.04(c) (Taksat dhe Tatimet)).

I/e nderuar zotëri/zonjë:

Referuar Marrëveshjes së Grantit të datës [_____] (“Marrëveshja e Grantit”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“Marrësi”), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (“Enti i Projektit”) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“BERZH”), ju informojmë se personat për të cilët më poshtë jepet modeli i nënshkrimit të tyre, janë të autorizuar që të nënshkruajnë Kërkesat për Pagesë dhe çdo lloj tjetër njoftimi ose dokumenti të kërkuar për ekzekutim nga Enti i Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje Granti.

EMRI POZICIONI MODELI I NËNSHKRIMIT

Ministri.....

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

SKEDULI 1

ZËRAT E FINANCUAR NGA GRANTI

1. Informacion paraprak:

Projekti do të financojë një pjesë të programit të përgjithshëm të investimit për rehabilitimin e seksioneve kryesore të rrjetit rrugor rajonal dhe vendor në Shqipëri, me gjatësi totale prej rreth 200 km. Rrugët janë në gjendje të keqe dhe janë pengesë për ndërlidhjen e transportit rajonal. Projekti do të përmirësojë cilësinë e shërbimit rrugor dhe sigurinë rrugore, dhe do të ulë kostot e operimit të mjeteve dhe do të shkurtojë kohën e udhëtimit. Përmbytjet dhe rrëshqitjet e tokës në vitet e fundit në Shqipëri kanë prekur gjithnjë e më shumë infrastrukturën rrugore dhe rrjedhimisht aksesin e popullsisë dhe fermerëve në tregje, i cili është ndërprerë në mënyrë të konsiderueshme. Në këtë aspekt, Projekti do të kontribuojë edhe për të përmirësuar rezistencën e rrugëve rajonale dhe lokale ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

2. Zërat e Financuar nga Granti:

Zërat e Financuar nga Granti përfshijnë Shërbimet e mëposhtme të Konsulencës:

Mbështetje për Zbatimin e Projektit deri në 1,200,000.00 dollarë amerikanë (Kontratë Konsulencë nr. Për t’u konfirmuar)

Konsulenti merr përsipër aktivitetet/detyrat e mëposhtme, siç përcaktohen specifikisht në Kontratën e Konsulencës:

i. Ofron asistencë për Njësinë e Zbatimit të Projektit lidhur me procesin e tenderit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në publikimin e tenderave, takimet para tenderit, shpalljen publike të tenderave, vlerësimin e tenderit, përfshirë pjesëmarrjen në komisionet e vlerësimit, sqarimet dhe nënshkrimin e kontratës;

ii. Asiston Klientin lidhur me menaxhimin/administrimin e punimeve dhe kontratat e inxhinierit të mbikëqyrjes dhe raportimin pranë BERZH-it, siç kërkohet në dokumentet përkatëse të financimit.